



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 3503 Prot

Vlorë, më 26 . 12 . 2017

VENDIM

Nr. 39 , Datë 20/12/2017

PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 20 . 12 . 2017 në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të VKM 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre” i ndryshuar si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Sarandë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr. 1/1, datë 26.04.2017 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin Kërkues **Z. Fuat Hajdini (subjekti Z. Fuat Hajdini me gjeneralitetet sipas çertifikatës së datës 10.08.1991)** për një objekt banimi (1 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 134 m² dhe sipërfaqe truall funksional 200 m², me vendndodhje në lagjen “Nr. 1“, të qytetit të Sarandës, zona kadastrale 8641, nr. pasurie 15/181 që kufizohet nga Veriu me rrugë, nga Jugu me rrugë, nga Lindja me pasurinë 15/25 dhe nga Perëndimi kufizohet me pasurinë 15/180.

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KRYETARI
Ervis MOÇKA